



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1276/prot.
12

Tiranë më 13.10.2017

REKOMANDIM

Nr. 46, datë 13.102017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Në zbatim të Urdhrit Nr. 244 datë 21.09.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "ERA POLIC SECURITY shpk" Durrës, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "ERA POLIC SECURITY shpk" Durrës.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin 244 datë 21.09.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "ERA-POLIC SECURITY shpk", ushtron aktivitetin e tij duke ofruar shërbime të ruajtjes së personave, objekteve dhe veprimtarive, shërbime të ruajtjes, transportimit shoqërimin të vlerave monetare e sendeve të çmuara, i pajisur nga QKB me licensë dhe NUIS: L32013503A.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale pranë Zyrës së Komisionerit më datë 25.09.2017, menjëherë mbas marrjes dijeni mbi hetimin administrativ që do të ushtrohej pranë këtij subjekti. Nga verifikimi i të dhënave të deklaruara në regjistrin elektronik të kontrolluesve, Zyra e Komisionerit konkludon se "Njoftimi" nuk është kryer i plotë sa i përket kategorisë së të dhënave

personale që përpunohen, të dhënat sensitive që përpunohen si dhe qëllimi i përpunimit të të dhënave. Konstatimi përbën shkelje administrative të neneve 21 dhe 22 të ligjit.

2. Kontrolluesi disponon rregullore për mbledhjen përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar "*Deklaratë Konfidencialiteti*" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale;
4. Kontrolluesi nuk ka publikuar "*Politikat e Privatësisë*" në portalin zyrtar të <http://www.erapolic.com>, çka përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit. Informacioni i publikuar në "*Politikat e Privatësisë*", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.
5. Nga verifikimi i bërë në ambientet në të cilat ERA-POLIC Security shpk ushtron aktivitetin e vet, u konstatua se subjekti nuk përdor sisteme video-vëzhgimi (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve.

Zyra e Komisionerit konkludon se kontrolluesi nuk ka respektuar detyrimet ligjore të parashikuara në nenet 18, 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 18, 21-23, 30, 31(1, a/1) dhe 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi "*ERA POLIC SECURITY shpk*" Durrës, të hartojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij rubrikën "*Politikat e Privatësisë*".
2. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi "*ERA POLIC SECURITY shpk*" Durrës, të kryejë përditësimin e "*Njoftimit*" pranë Zyrës së Komisionerit.
3. Kontrolluesi "*ERA POLIC SECURITY shpk*" Durrës, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit

nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.10 2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi